

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE**  
**MBROJTJES SE KONSUMATORIT**  
**MINISTRI**

**URDHER**

Nr. 194 Date 6.6 2011

**PËR**  
**MIRATIMIN E RREGULLORES " MBI DISA KUSHTE TË VEÇANTA QË**  
**RREGULLOJNE IMPORTIN E DISA USHQIMEVE TË CAKTUARA NGA DISA**  
**VENDE TË TRETA PËR SHKAK TË RREZIKUT TË NDOTJES NGA**  
**AFLATOXINAT "**


Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të ligjit nr.9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin", nenit 76 të ligjit 9590 datë 27.07.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European dhe shteteve të tyre anëtare" dhe V.K.M. Nr. 463 datë 05.07.2006 "Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit" i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullores " Mbi disa kushte të veçanta që rregullojnë importin e disa ushqimeve të caktuara nga disa vende të treta për shkak të rrezikut të ndotjes nga aflatoksinat ", si dhe shtojcat I dhe II, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij Urdhëri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**



## **RREGULLORE**

### **MBI**

#### **“DISA KUSHTE TË VEÇANTA QË RREGULLOJNË IMPORTIN E DISA USHQIMEVE TË CAKTUARA NGA DISA VENDE TË TRETA PËR SHKAK TË RREZIKUT TË NDOTJES NGA AFLATOKSINAT”**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

1. Kjo Rregullore zbatohet për importin e produkteve ushqimore, ushqimeve të përpunuara dhe të përbërësve të tyre të mëposhtëm:

(a) Produktet ushqimore që origjinojnë ose dërgohen nga Brazili:

- (i) Arrat e Brazilit me lëvozhgë që hyjnë në kategorinë me kod CN 0801 21 00;
- (ii) Përzierjet e arrave ose frutave të thata që hyjnë në kategorinë me kod CN 0813 50 dhe që përmbajnë arra të Brazilit me lëvozhgë;

(b) Produktet ushqimore që origjinojnë ose dërgohen nga Kina:

- (i) Kikirikët që hyjnë në kategorinë me kod CN 1202 10 90 ose 1202 20 00;
- (ii) Kikirikët që hyjnë në kategorinë me kod CN 2008 11 91 (në paketimet e menjëhershme të një përmbajtje neto që tejkalon 1 kg) ose 2008 11 98 (në paketimet e menjëhershme të një përmbajtje neto që nuk tejkalon 1 kg);
- (iii) Kikirikët e pjekur që hyjnë në kategorinë me kod CN 2008 11 91 (në paketimet e menjëhershme të një përmbajtje neto që tejkalon 1 kg) ose 2008 11 96 (në paketimet e menjëhershme të një përmbajtje neto që nuk tejkalon 1 kg);

(c) Produktet ushqimore që origjinojnë ose dërgohen nga Egjipti:

- (i) Kikirikët që hyjnë në kategorinë me kod CN 1202 10 90 ose 1202 20 00;
- (ii) Kikirikët që hyjnë në kategorinë me kod CN 2008 11 91 (në paketimet e menjëhershme të një përmbajtje neto që tejkalon 1 kg) ose 2008 11 98 (në paketimet e menjëhershme të një peshe neto që nuk tejkalon 1 kg);

(iii) Kikirikët e pjekur që hyjnë në kategorinë me kod CN 2008 11 91 (në paketimet e menjëhershme të një përmbajtje neto që tejkalon 1 kg) ose 2008 11 96 (në paketimet e menjëhershme të një përmbajtje neto që nuk tejkalon 1 kg);

(d) Produktet ushqimore që origjinojnë ose dërgohen nga Irani:

(i) Fistikët që hyjnë në kategorinë me kod CN 0802 50 00;

(ii) Fistikët e pjekur që hyjnë në kategorinë me kod CN 2008 19 13 (në paketimet e menjëhershme të një përmbajtje neto që tejkalon 1 kg) dhe 2008 19 93 (në paketimet e menjëhershme të një peshe që nuk tejkalon 1 kg);

(e) Produktet ushqimore që origjinojnë ose dërgohen nga Turqia:

(i) Fiq të thatë që hyjnë në kategorinë me kod CN 0804 20 90;

(ii) Lajthitë me lëvozhgë ose të qëruara që hyjnë në kategorinë me kod CN 0802 21 00 ose 0802 22 00;

(iii) Fistikët që hyjnë në kategorinë me kod CN 0802 50 00;

(iv) Përzierjet e arrave ose frutave të thata që hyjnë në kategorinë me kod CN 0813 50 që përmbajnë fiq, lajthi ose fistikë;

(v) Brumë fiku, brumë lajthie dhe brumë fistiku që hyjnë në kategorinë me kod CN 1106 30 90, 2007 10 ose 2007 99 ;

(vi) Lajthitë, fiqtë dhe fistikët, të përgatitur ose konservuar, që përfshijnë përzierjet që hyjnë në kategorinë me kod CN 2008 19;

(vii) Miell, pudër e lajthive, fiqve dhe fistikëve që hyjnë në kategorinë me kod CN 1106 30 90;

(viii) Lajthi të çara, të prera dhe të thërrmuara që hyjnë në kategorinë me kod CN 08022 22 00 dhe 2008 10;

(f) Produktet ushqimore që origjinojnë ose dërgohen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat janë të mbuluara nga Plani Vullnetar i Marrjes së Mostrave për Aflatoksina:

(i) bajame në levozhgë ose të qëruara që hyjnë në kategorinë me kod CN 0802 11 ose 0802 12;

- (ii) bajame të pjekura që hyjnë në kategorinë me kod CN 2008 19 13 (në paketimet e menjëhershme të një përmbajtje neto që tejkalon 1 kg) dhe 2008 19 93 (në paketimet e menjëhershme të një peshe që nuk tejkalon 1 kg);
- (iii) përzierjet e arrave apo të frutave të thata që hyjnë në kodin CN 0813 50 dhe që përmbajnë bajame;

(g) Produktet ushqimore të mëposhtme të importuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat nuk janë të mbuluara nga Plani Vullnetar i Marrjes së Mostrave për Aflatoksina:

- (i) bajame në lëvozhgë ose të qëruara që hyjnë në kategorinë me kod CN 0802 11 ose 0802 12;
- (ii) bajame të pjekura që hyjnë në kategorinë me kod CN 2008 19 1 (në paketimet e menjëhershme me një përmbajtje neto që tejkalon 1 kg) dhe 2008 19 93 (në paketimet e menjëhershme me një përmbajtje neto që nuk tejkalon 1 kg);
- (iii) përzierjet e arrave apo të frutave të thata që hyjnë në kodin CN 0813 50 dhe që përmbajnë bajame.

2. Pika 1 nuk zbatohet për dërgesat e produkteve ushqimore me një peshë bruto jo më shumë se 20 kg si dhe për produktet ushqimore të përpunuara ose për produktet ushqimore të përmendura në gërmat (b) deri në (g) të pikës 1 të cilat përmbajnë komplekse të ushqimeve në një sasi më pak se 20% .

## **Neni 2**

### **Përkufizimet**

Për qëllime të kësaj rregulloreje do të zbatohen, përkufizimet e dhëna në Ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 “ Për Ushqimin”.

## **Neni 3**

### **Importet**

Dërgesat e produkteve ushqimore të përmendura në Nenin 1, të importohen në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm kur janë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë Rregullore.

## **Neni 4**

### **Çertifikata e shëndetit, rezultatet e mostrimit dhe analizave**

1. Produktet ushqimore të lejohen të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm kur shoqërohen me rezultatet e mostrimit, analizave dhe me një çertifikatë

shëndeti në përputhje me modelin e përcaktuar në Shtojcën I, e plotësuar, nënshkruar dhe vërtetuar nga përfaqësuesi i autorizuar nga:

- (a) Ministria e Bujqësisë, Blegtorisë dhe Ushqimit për produktet ushqimore nga Brazili;
- (b) Administrata Shtetërore për Kontrollin e Hyrje-Daljeve dhe Karantinën e Republikës Popullore të Kinës për produktet ushqimore nga Kina;
- (c) Ministria e Bujqësisë e Egjyptit për produktet ushqimore nga Egjypti;
- (d) Ministria Iraniane e Shëndetësisë për produktet ushqimore nga Irani;
- (e) Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes dhe Kontrollit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Çështjeve Rurale e Turqisë për produktet ushqimore nga Turqia.
- (f) Departamenti i Bujqësisë i Shteteve të Bashkuara (DBSHBA) për produktet ushqimore nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

2. Çertifikata e shëndetit të jetë e hartuar në gjuhën zyrtare të vendit eksportues dhe në gjuhën shqipe.

3. Çertifikata e shëndetit e parashikuar në pikën 1 është e vlefshme për importin e produkteve ushqimore për në territorin e Republikës së Shqipërisë jo më vonë se katër muaj nga data e lëshimit.

4. Marrja e mostrave dhe analizat e përmendura në pikën 1 të jenë në përputhje me Udhëzimin nr.12, datë 29.09.2010 për “Metodat e marrjes së mostrave dhe analizimit për kontrollin zyrtar të niveleve të mykotoksinave në produktet ushqimore”.

5. Çdo ngarkesë e produkteve ushqimore të jetë identifikuar me një kod i cili korrespondon me kodin në rezultatet e marrjes së mostrave, analizave dhe çertifikatën e shëndetit të përmendur në pikën 1. Çdo qese individuale, ose forma të tjera të paketimit të dërgesave të jetë identifikuar me këtë kod.

## **Neni 5**

### **Njoftimi paraprak i dërgesave**

Operatorët e biznesit ushqimor ose përfaqësuesit e tyre duhet të japin njoftimin paraprak të datës së parashikuar dhe kohën e arritjes fizike të ngarkesës në Pikën e Inspektimit Kufitar (PIK), si dhe natyrën e dërgesës.

Për këtë qëllim, duhet të plotësojnë pjesën I të dokumentit të përbashkët të hyrjes (DPH) dhe ta dërgojnë këtë dokument inspektorit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë të AKU-së në pikën e inspektimit kufitar, së paku një ditë pune para ardhjes fizike të dërgesës .

Plotësimi i DPH nga operatorët e biznesit ushqimor bëhet sipas përcaktimeve të Shtojcës II.

## **Neni 6**

### **Kërkesat për pikat e inspektimit kufitar**

1. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) në pikat e inspektimit kufitar siguron:

- a) praninë e personelit të trajnuar për të kryer kontrollin zyrtar të ngarkesave të produkteve ushqimore;
- b) pajisjen e inspektorëve të ushqimit dhe ushqimit për kafshë me metoda të hollësishme në lidhje me marrjen e mostrave dhe dërgimin e mostrave në laborator, në përputhje me Udhëzimin nr.12, datë 29.09.2010 për “Metodat e marrjes së mostrave dhe analizimit për kontrollin zyrtar të niveleve të mykotoksinave në produktet ushqimore”;
- c) marrjen e mostrave;
- d) pajisjet për shkarkim dhe pajisje të përshtatshme për marrjen e mostrave;
- e) dërgimin e mostrave brenda një periudhe të shkurtër kohore në një laborator zyrtar të autorizuar për analizat e aflatoksinave, i cili është në gjendje të kryej këto analiza.

2. Operatori i biznesit ushqimor duhet të sigurojë shkarkimin e ngarkesës të produkteve ushqimore të domosdoshme për marrjen e mostrave përfaqësuese.

Në rastin e transportit të veçantë ose të formave specifike të paketimit, operatori të vërë në dispozicion të inspektorit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, pajisje të përshtatshme për marrjen e mostrave për sa kohë që nuk mund të kryhet marrja e mostrave përfaqësuese me pajisje të zakonshme.

## **Neni 7**

### **Kontrollet zyrtare**

1. Të gjitha kontrollet zyrtare para miratimit për lejim për qarkullim të lirë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe përfundimi i dokumentit të përbashkët të hyrjes të kryhen brenda 15 ditëve punë, nga momenti kur ngarkesa ka ardhur në pikën e inspektimit kufitar dhe është gati për marrjen e mostrave.

2. Inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë i AKU-së në pikën e inspektimit kufitar kontrollon dokumentacionin që shoqëron produktet ushqimore të destinuara për në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të siguruar që kërkesat për rezultatet e

mostrimit, analizave dhe çertifikata e shëndetit janë në përputhje me kërkesat e parashikuara në Nenin 4.

Kur një ngarkesë me produkte ushqimore nuk është shoqëruar me rezultatet mostrimit, analizave dhe çertifikatën e shëndetit të parashikuar në Nenin 4 (1), dërgesa nuk mund të hyjë në territorin e Republikës së Shqipërisë, por të ridërgohet në vendin e origjinës ose të shkatërrohet.

3. Inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë i AKU-së në pikën e inspektimit kufitar duhet të marrë mostra për analizën e aflatoksinës B1 dhe kontaminimin total të aflatoksinave në dërgesa të caktuara me një frekuencë të dhënë në pikën 4 dhe në përputhje me Udhëzimin nr.12, datë 29.09.2010 për “ Metodat e marrjes së mostrave dhe analizimit për kontrollin zyrtar të niveleve të mykotoksinave në produktet ushqimore”, para lejimit për qarkullim të lirë.

4. Marrja e mostrave për analiza të përmendura në pikën 3 të kryhet në:

- a) 100% e dërgesave të ushqimeve nga Brazili;
- b) rreth 20% e dërgesave të ushqimeve nga Kina;
- c) rreth 20% e dërgesave të ushqimeve nga Egjipti;
- d) rreth 50% e dërgesave të ushqimeve nga Irani;
- e) rreth 10% e ngarkesave për çdo kategori të lajthive dhe produkteve që vijnë nga Turqia të përmendura në Nenin 1 (1) (e) (ii), (iv) dhe (viii), rreth 20% e ngarkesat për secilën kategori të fijeve të thate dhe produkteve që vijnë nga Turqia të përmendura në Nenin 1(1) (e) (i), (iv) dhe (vii) si dhe rreth 50% ngarkesave për se cilën kategori të fistikëve dhe produkteve që vijnë nga Turqia të përmendura në Nenin 1 (1) (e) (iii) dhe (vii);
- f) në mënyrë të rastësishme për dërgesat e ushqimeve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të përmendura në Nenin 1 (1) (f);
- g) çdo ngarkesë të produkteve ushqimore nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës të përmendura në Nenin 1 (1) (g).

5. Pas përfundimit të kontrolleve, për kontrollet e kryera prej tij, inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë i AKU-së në pikën e inspektimit kufitar duhet:

- a) të plotësojë pjesën e II-të të dokumentit të përbashkët të hyrjes (DPH);
- b) të bashkojë rezultatet e mostrave dhe analizave;
- c) të vulosë dhe të nënshkruaj origjinalin e DPH;
- d) të bëjë dhe të mbajë një kopje të nënshkruar dhe të vulosur DPH.

6. Originali i DPH të shoqërojë dërgesën gjatë transferimit të saj.

## Neni 8

### Ndarja e ngarkesës

Dërgesa nuk do të ndahet derisa të kenë përfunduar të gjitha kontrollet zyrtare dhe të jetë plotësuar DPH nga inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë i AKU-së në pikën e inspektimit kufitar, siç parashikohet në Nenin 7.


Në rastin e ndarjes së mëvonshme të dërgesës, një kopje e vërtetuar e DPH do të shoqërojë çdo pjesë të dërgesës.

## Neni 9

### Kushte shtesë në lidhje me importet e produkteve ushqimore nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës

1. Përsa i përket importeve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, analizat e përmendura në Nenin 4 (1) duhet të jenë kryer në një laborator të miratuar për analiza të aflatoksinave nga DBSHBA.

2. Çertifikata e shëndetit e përmendur në Nenin 4 (1), shoqëruese e dërgesave të ushqimeve të përmendura në Nenin 1 (1) (f) duhet të ketë një referencë në Planin Vullnetar të Marrjes së Mostrave për Aflatoksina.





**SHTOJCA I**  
**Çertifika e Shëndetit**

..... (\*)

**Kodi i ngarkesës:** ..... **Çertifikata Nr:** .....

Në bazë të dispozitave të Rregullores ( NNN/2011) që vendos kushte të veçanta që rregullojnë sigurinë e ushqimeve të caktuara nga disa vendeve të treta për shkak të rrezikut të ndotjes nga aflatoksinat

.....  
..... (Autoriteti Kompetent referuar nenit 4 (1)

VERTETON që .....  
..... (përfshin ushqimet e referuara në Nenin 1)

kjo ngarkesë është e përbërë nga: .....

(përshkruan ngarkesën , produktin, numrin dhe tipin e paketimit, peshën neto ose bruto)

nisur nga .....(vendi i nisjes)

me .....(identifikimin e transportuesit)

shkon në ..... (vendin dhe shtetin e destinacionit)

I cili vjen nga stabilimenti: .....

.....(emri dhe adresa e stabilimentit)

kanë qenë të prodhuara, ruajtura, manipuluar, përpunuara, paketuara dhe transportuara në përputhje me praktikat e mira të higjienës.

Nga kjo ngarkesë , mostrat janë marrë në përputhje me rregulloren Nr. 401/2006/KE\* me.....(data),nënshtuar analizave laboratorike me.....(data)

në ..... (emëri i laboratorit),  
për përcaktimin e nivelit të kontaminimit me aflatoksinën B1 dhe aflatoksinat totale. Detajet e mostrimit, metodat e analizës së përdorur dhe gjithë rezultatet e mbajtura

Kjo çertifikatë është e vlefshme deri më: .....

Bërë më: ..... në .....

Vulosur dhe firmosur nga përfaqësuesi i autorizuar i autoritetit kompetent referuar në Nenin 4(1)

(\*)Rregullorja Nr. 401/2006/KE e legjislacionit europian është e përshtatur në akt nënligjor shqiptar me Udhëzimin nr.12, datë 29.09.2010 për “ Metodat e marrjes së mostrave dhe analizimit për kontrollin zyrtar të niveleve të mykotoksinave në produktet ushqimore ”

## SHTOJCA II

### **Udhëzim për plotësimin e DPH në zbatim të kësaj Rregulloreje në rast të importit të produkteve ushqimore nga disa vende të treta, për shkak të rrezikut të ndotjes së këtyre produkteve nga aflatoksinat**

Dokumenti plotësohet me shkronja kapitale. Shënimet janë treguar ndaj numrit në kutinë përkatëse.

#### **Pjesa I Ky seksion të plotësohet nga operatori i biznesit ushqimor ose përfaqësuesit e tyre.**

- Kutia I.1. Dërguesi: emrin dhe adresën e plotë të personit fizik apo juridik (operatori i biznesit ushqimor) nga niset ngarkesa. Informacion mbi numrat e telefonit dhe faksit apo adresat e e-mail-it të rekomanduara.
- Kutia I.2. Marrësi i ngarkesës: të tregojë emrin e plotë dhe adresën e personit fizik apo juridik (operatori i biznesit ushqimor) për të cilin ngarkesa është destinuar. Informacion mbi numrat e telefonit dhe faksit apo adresat e e-mail-it të rekomanduara.
- Kutia I.3. Personi përgjegjës për dërgesën: (gjithashtu, agjenti, deklaruesi ose operatori i biznesit ushqimor) të tregojë emrin dhe adresën e plotë të personit i cili është përgjegjës për ngarkesën kur të paraqitet në pikën e inspektimit kufitar dhe bën deklaratat e nevojshme në emër të importuesit. Informacion mbi numrat e telefonit dhe faksit apo adresat e e-mail-it të rekomanduara.
- Kutia I.4. Vendi i origjinës: të tregojnë vendin e origjinës të produktit ku është rritur, korrur, vjelur ose prodhuar.
- Kutia I.5. Vendi nga ku dërgohet: të tregojë vendin ku ngarkesa është vendosur në bordin e mjetit për transportin përfundimtar për të udhëtuar për në Shqipëri.
- Kutia I.6. Importuesi: të tregojë emrin dhe adresën e plotë. Informacion mbi numrat e telefonit dhe faksit apo adresat e e-mail-it të rekomanduara.
- Kutia I.7. Vendi i destinacionit: adresa e marrësit në Shqipëri. Informacion mbi numrat e telefonit dhe faksit apo adresat e e-mail-it të rekomanduara.
- Kutia I.8. Mbërritja në Pikën e Inspektimit Kufitar (data e parashikuar): të jepet data e parashikuar në të cilën pritet që dërgesa të arrijë në PIK

- Kutia I.9. Dokumentat: të shënohet data e lëshimit dhe numri i dokumenteve zyrtare që shoqërojnë ngarkesën.
- Kutia I.10. Mjetet e transportit: të shënohet kutia për të treguar mjetet e transportit.
- Identifikimi: të jepen detaje të plota në lidhje me mjetet e transportit. Për aeroplanë: të tregojë numrin e fluturimit. Për anijet: të tregojë emrin e anijes. Për automjetet rrugore: të tregojë targën e automjetit dhe të rimorkios. Për transportin hekurudhor: të tregojë identitetin e trenit dhe numrin e vagonave.
- Kutia I.11. Përshkrimi i produkteve ushqimore: të sigurojë një përshkrim të hollësishëm të produkteve ushqimore duke përdorur terminologjinë e Nenit 1.
- Kutia I.12. Pesha bruto: të specifikojë peshën e përgjithëshme në kg apo ton. Kjo është përcaktuar si masa totale e produkteve që janë në kontenier dhe i të gjithë ambalazhave të tyre, por duke përjashtuar kontenierët e transportit dhe pajisjet e tjera të transportit.
- Pesha neto: të përcaktojë peshën e produktit aktual në kg apo ton, me përjashtim të paketimit. Kjo është përcaktuar si masa e vet produktit pa kontenierët ose çdo paketim.
- Kutia I.13. Numri i pakove: të specifikojë numrin e pakove (ambalazheve) në ngarkesë.
- Kutia I.14. Temperatura: të shënohet në mënyrën e duhur temperatura e ruajtjes gjatë transportit.
- Kutia I.15. Lloji i paketimit: të identifikojë llojin e paketimit të produkteve.
- Kutia I.16. Mall i destinuar për: të shënohet në kutinë e duhur në varësi të faktit nëse produkti ushqimor është i destinuar për konsum njerëzor pa klasifikim paraprak ose trajtim tjetër fizik (në këtë rast shënohet “për konsum njerëzor”) apo është destinuar për konsum njerëzor pas trajtimeve të tilla (shënohet në këtë rast “me përpunim të mëtejshëm”), ose kur është i destinuar të përdoret si “ushqim për kafshë” (në këtë rast shënoni “ushqim për kafshë”). Në rastin e fundit dispozitat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen.
- Kutia I.17. Numri i vulës dhe numri i kontenierit : të japë të gjithë numrat e vulave si dhe numrat e identifikimit të kontenierëve.
- Kutia I.18. Pika e Inspektimit Kufitar: të shënohet kutia që identifikon pikën e inspektimit kufitar.

Të tregohen qartë veprimet që do të kryhen në raste të tilla me anë të një shënimi në kutitë ("Ri-dërgim", "Shkatërrim", "Transformim" ose "Përdorim për qëllime të tjera").

Kutia II.10. Arsyet për refuzimin: të shënohet kutia e duhur. Përdoret sipas nevojës për të shtuar informacione të rëndësishme.

Kutia II.11. Ngarkesë e rivulosur: të përdoret kjo kuti kur vula origjinale e regjistruar në një ngarkesë është shkatërruar gjatë hapjes së kontenierit. Të mbahet një listë për të gjitha vulat që janë përdorur për këtë qëllim.

Kutia II.12. Inspektori zyrtar: të vendoset emri (me shkronja kapitale), data e lëshimit dhe nënshkrimi i inspektorit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë në pikën e inspektimit kufitar.

**Pjesa III Ky seksion të plotësohet nga inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë i AKU-së në Pikën e Inspektimit Kufitar.**

Kutia III.1. Detaje mbi ridërgimin: inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë i AKU-së në Pikën e Inspektimit Kufitar të tregojë mjetet e transportit të përdorura, identifikimin e tyre, vendin e destinacionit dhe datën e ridërgimit.

Kutia III.2. Në vazhdim: të tregojë njësinë përgjegjëse, sipas rastit, për mbikëqyrjen në rastin e "Shkatërrimit", "Transformimit" apo "Përdorimit për qëllime të tjera" të dërgesës.

Kutia III.3. Inspektori zyrtar : nënshkrimi i inspektorit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë në PIK në rast të "Ridërgimit". Nënshkrimi i zyrtarit përgjegjës në rast të "Shkatërrimit" "Transformimit" ose "Përdorimi për qëllime të tjera".